



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNİ PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.15/2026

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Arsim Hamzaj - kryesues, Kymete Kicaj dhe Skender Çoçaj - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Za Slobodu Pravdu i Opstanak, me seli në Graçanicë, e paraqitur kundër subjektit politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicë të Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 7 qershor 2026, në seancën e panelit të mbajtur më datë 05.06.2025, merr këtë:

V E N D I M

I. PRANOHET e bazuar ankesa e subjektit politik Za Slobodu Pravdu i Opstanak, me seli në Graçanicë, ZP.Anr.15/2026, e datës 04.06.2026, kundër Subjektit Politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 7 qershor 2026.

II. Subjektit politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicë të Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënim më gjobë në lartësi prej 2,000.00 (dy mijë) Euro.

III. Detyrohet Subjekti politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicë të Veriut, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II- të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë 04.06.2026, PZAP-i, ka pranuar një ankesë të parashtruar nga Subjekti Politik Za Slobodu Pravdu i Opstanak, ku pretendohet se aktivistët e subjektit politik "Za Slobodu Pravdu i Opstanak", më datë 04.06.2026, gjatë mbikëqyrjes së aktiviteteve të subjekteve të tjera politike, vërejtën se përkrahësit e subjektit politik Lista Serbe në territorin e komunës së Novobërdës, në fshatin Prekoc, kanë ngjitur në vende të paautorizuara që janë në pronësi

shtetërore (stacione autobusësh) afishe, gjë që është në kundërshtim me kodin e sjelljes së subjekteve politike, duke përdorur objektet për promovim dhe duke shkelur rregullat e fushatës zgjedhore, duke qenë se kanë ngjitur afishe në vende që nuk janë të parapara për këtë. Kanë kërkuar nga PZAP që ta pranojë ankesën si të bazuar dhe subjektit politik Lista Serbe ti vë sanksion në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Si dëshmi kanë bashkëngjitur fotografi të afisheve të lartcekura.

Subjekti politik Lista Serbe, me datë 05.06.2026, ka paraqitur përgjigje në ankesë në të cilën ka theksuar se i hedhin poshtë plotësisht si të pabazuara pretendimet e paraqitura në ankesë si dhe kanë theksuar se si subjekt politik i përgjegjshëm, dhe pas përvojave nga ciklet e mëparshme zgjedhore, në këtë proces zgjedhor kanë vendosur që absolutisht të mos përdorim postera si formë e materialit propagandistik dhe promovues politik. Në këtë kuptim, bashkë me përgjigjen në ankesë kanë dorëzuar kontratat për furnizim me material promovues, në të cilat shihet qartë se nuk kemi porositur asnjë poster, dhe për rrjedhojë nuk kemi mundur as t'i vendosim ato në stacionin e autobusit në fshatin Prekoc, në komunën e Novobërdës. Tutje kanë theksuar se ne besojmë thellësisht se kjo është një mënyrë klasike e zëvendësimit të posterave dhe fajësimit të subjektit tonë politik, veçanërisht sepse një material i tillë propagandistik nuk mund të gjendet askund në territorin e Kosovës. Prandaj, me përgjegjësi e hedhim poshtë përgjegjësinë për vendosjen e këtij materiali, sepse të njëjtin nuk do ta gjeni askund në aktivitetet tona promovuese, as në 38 komunitat e Kosovës ku ne e zhvillojmë fushatën tonë. Në ankesë theksohet se pas marrjes së kësaj ankese, në të njëjtin moment kemi nisur veprimin për të gjetur stacionin e përmendur dhe kemi hequr të gjithë materialin prej tij, dhe fotot i bashkëngjisim në dokumentacionin shoqëruar. Dëshirojmë të theksojmë edhe një herë se ky është një falsifikim i qartë dhe se Lista Serbe nuk i ka prodhuar posterat, e veçanërisht jo ato të përmendurat. Kanë kërkuar nga PZAP që ta refuzojë ankesën si të pabazuar.

Si dëshmi përgjigjes në ankesë i kanë bashkëngjitur dokumentet si në vijim:

- Kontrata me numër 179/2026 e datës 21.05.2026
- Kontrata me numër 180/2026 e datës 21.05.2026
- kontrata me numër 181/2026 e datës 21.05.2026
- Fotografi të stacioneve të autobusëve ku shihet largimi i materialit promovues.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës vlerësoi se:

-Ankesa është e bazuar.

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndëve, përkatësisht ankesës ZP.Anr.15/2026, si dhe pas vlerësimit të provave të bashkëngjitura në ankesë dhe përgjigjes në të, PZAP-i, vlerëson se pretendimet e subjekti politik Za Slobodu Pravdu i Opstanak janë të bazuara.

Nga provat e parashtruara konstatohet se subjekti politik Lista Serbe ka vendosur materiale promovuese zgjedhore në disa hapësira publike, konkretisht në pritore të autobusëve në fshatin

Prekoc, në komunën e Novobërdës, veprime këto që përbëjnë shkelje nga ana e subjektit politik Lista Serbe, pasi materialet promovuese zgjedhore janë vendosur në hapësira publike. Rrjedhimisht, me këto veprime është shkelur neni 34, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 i Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, i cili ndalon vendosjen e njoftimeve, pllakateve, posterëve, emrave ose sloganeve të fushatës zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike, në ose mbi rrugë publike, në shenja publike të trafikut, në hapësira të shfrytëzuara nga organizata ndërkombëtare, si dhe në hapësira private pa lejen e pronarit ose shfrytëzuesit.

Subjekti Politik Lista Serbe ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësitë gjatë procesit të fushatës zgjedhore, andaj vendosja e materialeve promovuese në fushatë zgjedhore pa lejen e organeve kompetente, përbën shkelje të legjislacionit zgjedhor, të cilat shkelje janë sanksionuar me dispozitat ligjore të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Në përgjigjen në ankesë, subjekti politik Lista Serbe ka pretenduar se është bërë zëvendësimi i posterave, dhe që subjekti politik Lista Serbe nuk kanë përdor material promovues në formë të posterave për këtë proces zgjedhor, deklarata kjo që del kontradiktore duke qenë se vet subjekti politik Lista Serbe në prova e paraqitura shihet qartë se listën e materialeve të listuara ka edhe shtypjen e flyer-ave në të dyja anët në formatin A4, me ngjyrë, sasi 20.000 copë.

Paneli ka vlerësuar edhe kontratën numrin 179/2026 me datë 21.05.2026 me OTISAK PLUS L.L.C. si shitës, paraqitur si dëshmi mirëpo ka vlerësuar se e njëjta nuk ka ndikim në vendosjen ndryshe në këtë rast, për faktin se Lista Serbe ka lidhur kontratën e cekur për prodhimin e materialit promovues, mirëpo nuk ka autorizim nga organi kompetent për vendosjen e materialit promovues në hapësira publike. Sa i përket kontratave me numër 180/2026 dhe 181/2026 të datës 21.05.2026, pas vlerësimit të tyre Paneli konsideroj se të njëjtat janë irelevante për vendosje në këtë rast, duke qenë se materiali i printuar në ato kontrata nuk është objekt i ankesës dhe nuk u lëshua në arsyetimin e tyre.

Paneli, me rastin e shqiptimit të gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes si dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, kjo për faktin se subjekti politik Lista Serbe qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të votimit. Si rrethanë lehtësuese Paneli ka vlerësuar faktin se subjekti në fjalë ka ndërmarr veprime pas pranimit të ankesës dhe ka larguar posterët e vendosur në hapësira publike.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se “Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e palës ankuese janë të qëndrueshme dhe si të tilla i pranoi, sepse ndalimi i këtyre shkeljeve ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod, me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës, demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit. Veprimet e përshkruara në

ankesë nga parashtruesi i ankesës paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën siç është cek me lartë i pranoi si të bazuara. Andaj si përfundim, Paneli ka vlerësuar se veprimet e subjektit politik Lista Serbe janë në kundërshtim me nenin 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe nenin 120 par 2 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZP.Anr.15/2026 më datën 05.06.2025

Kryesues i Panelit,
Arsim Hamzaj



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa konform nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 Për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës.